



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr. 1, datë 30.01.2020

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT “PLANI STRATEGJIK I INSPEKTIMIT TË SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi Frashëri	Kryetar
Z.	Alban Karapici	Anëtar
Znj.	Ketrin Topçiu	Anëtar
Znj.	Xhoana Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 30.01.2020, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Miratimi i dokumentit “Plani Strategjik i Inspektimit të Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”**

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 8 dhe 132 e në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Kapitulli I, Pika 1.8, Kapitulli II, Pika 2.5 e Rregullores Nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”.
3. Rregullore Nr. 2, datë 21.02.2008 “Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën “.AL” dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, org.al dhe .net.al”, e ndryshuar

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Relacionin shpjegues mbi çështjen në shqyrtim;
- Aktin e propozuar për miratim;
- Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se:

Dokumenti “Plani Strategjik i Inspektimit të Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” është hartuar me qëllim rregullimin e veprimtarisë inspektuese të AKEP sipas Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Rregullores Nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”.

Dokumenti i përgatitur përcakton drejtimit dhe objektivat kryesore të inspektimit në terma afatgjatë (3 vjeçar).

Për të garantuar ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji, veçanërisht të zbatimit të kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm si dhe të përdorimit të frekuencave dhe numeracionit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Autorizimet Individuale, AKEP kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve dhe monitorimin e përdorimit të spektrit prej tyre.

Dokumenti “Plani Strategjik i Inspektimit”, i propozuar nga struktura përgjegjëse në AKEP, është i bazuar ligjërisht dhe në përputhje me strategjinë dhe funksionet e AKEP në përmbushjen e objektivave rregullatorë të përcaktuara në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Praktika dokumentare për shqyrtim të çështjes sipas objektit është paraqitur nga struktura përgjegjëse në AKEP, në përputhje me kërkesat procedurale të përcaktuara në nenin 13 të Rregullores së Brendshme “Për funksionimin e Këshillit Drejtues”, të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Pasi e gjen dokumentin në përputhje me kërkesat ligjore në mbështetje të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregullores Nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, si dhe bazës ligjore sipërcituar, duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918/2008, Këshilli Drejtues i AKEP;

V E N D O S:

1. Të miratojë dokumentin “Plani Strategjik i Inspektimit të Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”.
2. Ky Vendim dhe dokumenti “Plani Strategjik i Inspektimit të Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al.

3. Dokumenti “Plani Strategjik i Inspektimit të Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” t’i përcillet Inspektoratit Qendror brenda 15 ditëve nga data miratimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR	ANËTAR	ANËTAR	ANËTAR
Tomi Frashëri	Alban Karapici	Ketrin Topçiu	Xhoana Lilaj

www.akep.al



PLANI STRATEGJIK I INSPEKTIMIT
2020 - 2023

*TË SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE*

Përmbajtje

1. Hyrje.....	3
2. Misioni i Planit Strategjik të Inspektimit.....	5
3. Kuadri Ligjor.....	8
4. Objektivat e Sektorit të Kontrollit dhe Inspektimit për vitet 2020 - 2023.....	9
5. Qëllimet Strategjike dhe Tematikat për vitet 2020 - 2023.....	11
6. Inspektime të Bazuara në Vlerësimin e Rrezikut.....	14
7. Objekti i Përgjithshëm i Autorizimit të Inspektimit.....	19
8. Pritshmëritë dhe Angazhimi.....	21

1. Hvrie

Në referim të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP është përcaktuar si autoriteti kombëtar përgjegjës për mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve elektronike si dhe administron domain-in “.al”. Me qëllim ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve publike, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor, veçanërisht lidhur me zbatimin e kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm dhënë subjekteve ofrues të shërbimeve publike AKEP kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve elektronike.

Inspektimi është një hallkë e rëndësishme e shtetit ligjor për përmirësimin e klimës së biznesit dhe ndërgjegjësimin e subjekteve në zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore të vendosura. Inspektimi në vetvete sipas përcaktimeve ligjore që e rregullojnë ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë. Ky qëllim i veprimtarisë së inspektimit arrihet nëpërmjet vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit si dhe dokumentimit të praktikave të mira në respektimin e kërkesave ligjore dhe përhapjen e tyre. Inspektimi do të mund të arrijë efektivitet maksimal nëse kryhet në kushtet e një bashkëpunimi reciprok dhe me përgjegjshmëri me subjektet e inspektimit. Një metodë e tillë siguron arritjen e rezultateve më të mira të përbashkëta, dhe kjo për arsye se askush tjetër nuk ka njohje më të thellë dhe më të mirë të veprimtarisë së subjekteve të inspektimit. Në këtë funksion mbas vlerësimit të mësipërm duhet të fillohet me këshillimin e subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore dhe urdhërimin e korigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimin e pasojave që rrjedhin prej tyre dhe vetëm mbasi janë ezauruar këto hapa dhe ku ligji detyron vazhdohet me dhënien e dënimeve dhe marrjen e masave të tjera administrative për shmangien e rreziqeve që mund t’u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë, të parashikuar nga ligji inspektimit apo legjisllacioni i posaçëm. Grupet e inspektimit duhet të kenë gjithmonë parasysh se në përcaktimin e një afati për korigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojave të tyre nga subjekti i inspektimit, merret në konsideratë rëndësia e shkeljes, pasojat e saj dhe rrethanat konkrete që përcaktojnë kohën e nevojshme për kryerjen e veprimeve për këtë qëllim, me përpjekjet maksimale nga ana e subjektit të inspektimit. Po ashtu, në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet marrë, inspektori, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, vendos atë sanksion apo merr atë masë që është domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të dënimit apo masës dhe që cenon më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të subjektit të inspektimit. Në çdo rast apo rrethanë inspektori apo grupi i inspektimit, brenda kompetencave të dhëna me ligj apo akt nënligjor, është plotësisht i pavarur në kryerjen e procedimit të inspektimit dhe marrjen e vendimeve për një rast konkret.

Një nga objektivet parësore, të theksuara në këtë dokument, të strukturës inspektimit është të vijojë të jetë partnere e sipërmarrësve dhe një kontributore aktive në fuqizimin e mire-operimit dhe llogaridhënies publike në funksion të promovimit të transparencës, eficiencës në treg, efektivitetit dhe zbatueshmërisë ligjore. Në këtë kuadër thellimi i luftës kundër informalitetit është në fokus të

veprimtarisë tone institucionale për tre vjeçar in e ardhshëm. Vizioni jonë i përpunuar e paraqitur në këtë plan strategjik shkon përtej qasjes tradicionale të fokusuar në inspektime, vlerësime dhe konstatime tematike dhe periodike. Inspektorët tanë e realizojnë aktivitetin e tyre jo vetëm duke vepruar e marrë thjeshtë masa administrative por duke bashkëvepruar nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillimeve të subjekteve të inspektuara për të maksimizuar vlerën e detyrës së ngarkuar me ligj. Drejtoria Monitorimit Kontrollit dhe Inspektimit si struktura inspektuese e AKEP synon të vazhdojë të veprojë si një agjent ndryshimi, në shërbim të përdoruesit dhe të shërbimit të mirë duke reflektuar vlerat dhe parimet e një inspektimi modern, anëtar i dedikuar i komunitetit të Inspektoratit Qendror.

DMKI, synon të vijojë edhe në këtë tre vjeçar me zhvillimin e zbatimin e metodologjisë për orientimin e inspektimit bazuar në risk, duke u përqendruar në kontrollin e sipërmarrësve me ekspozim më të lartë ndaj risqeve të identifikuar. Objektivi strategjik “Inspektim mbi bazë Risku” mbështetet aktualisht jo vetëm në vazhdueshmërinë e planifikimit strategjik dhe për tre vitet e ardhshme por dhe nga aktivitetet konkrete në ndjekje për të zhvilluar strategjinë inspektuese të bazuar në risk si qasje për të gjitha llojet e inspektimit edhe ato në kuadër të nismës më të fundit të AKEP si plani veprimi për luftën kundër informalitetit. Kjo do të realizohet nëpërmjet krijimit dhe përdorimit të instrumenteve të veçantë të zbatimit në vijimësi dhe në mënyrën e duhur të inspektimit në bazë risku në praktikë, si dhe në modernizimin e parametrave ndjekës dhe treguesve të përdorur në hartimin e “Matricës së Riskut”. Kryerja e inspektimeve sipas kësaj matrice përcaktojnë veprimet që DMKI do të ndërmarrë për rritjen e numrit dhe cilësisë së tyre po ashtu dhe të efikasitetit strukturor dhe efikasitetit institucionale duke pasqyruar në gjithë veprimtarinë inspektuese transparencë, integritet dhe përgjegjshmëri.

Disa nga parimet bazë të funksionimit të çdo strukture kontroll-inspektimi është transparencja, përgjegjshmëria por dhe integriteti e dedikimi. Për zbatimin real të këtyre parimeve, është ndërtuar tre vjeçar in e kaluar infrastruktura ligjore dhe metodologjike, që mundëson vlerësimin mbi baza planifikimi dhe raportimi të performancës institucionale duke përdorur standardet, rekomandimet dhe praktikën më të mira të fushës. Rezultatet e kësaj qasje na inkurajojnë për t’u ballafaquar me problematikat si dhe të përcaktojmë në këtë Plan Strategjik aspektet që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në referencë të praktikave më të mira të fushës. Kjo qasje metodologjike nuk përbën qëllim në vetvete por është një përmbushje e misionit dhe angazhimit të DMKI por dhe vetë AKEP për të sjellë vlerë për përdoruesit dhe sipërmarrësit.

Një subjekt sipas këtyre përcaktimeve ligjore të sipërpërmendura mund dhe duhet të inspektohet vetëm në zbatim të planeve të miratuara të inspektimit (vjetor apo mujor). Përgjashtimisht, një subjekt mund të inspektohet jashtë programit në rastet e parashikuara shprehimisht në ligj apo dhe përcaktimeve në akte nënligjore siç janë dhe ato të parashikuara në *Rregulloren Nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbime të Komunikimeve Elektronike”*. Struktura inspektuese e AKEP sipas përcaktimeve të Metodikës së mësipërme dhe planifikimit strategjik do të ushtrojë inspektimin pranë të gjithë subjekteve ofrues të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të paktën një herë në dy vjet.

Sa më sipër, dokumenti “Plani Strategjik i Inspektimit” i detajuar më poshtë paraqitet i nevojshëm për të përcaktuar qëllimin, misionin dhe objektivat e strukturave përgjegjëse në DMKI për ushtrimin e veprimtarisë inspektuese të AKEP.

Misioni i Planit Strategjik të Inspektimit

Për të garantuar ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me Ligjin Nr. 9918/2008 dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji, veçanërisht të zbatimit të kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm si dhe të përdorimit të frekuencave dhe numeracionit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Autorizimet Individuale, strukturat inspektuese në AKEP kryejnë në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve dhe monitorimin e përdorimit të spektrit prej tyre.

- Qëllimi i këtij misioni është kryerja e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe marrja e masave që janë, këshillimi i subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore dhe urdhërimin e korigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimin e pasojave që rrjedhin prej tyre por dhe vendosja e sanksioneve në rastet e vërtetimit të kundërvajtjeve administrative, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe nënligjore, kompetencat e AKEP dhe parimet e së drejtës;
- Inspektimi nënkupton një veprimtari të programuar, mbi disa rregulla të mirë përcaktuara për të parandaluar dhe kontrolluar mospërputhjen e kërkesave ligjore të vendosura sipas legjislacionit në fuqi, nga ana e subjekteve ku ushtrohet inspektimi ku parësore është zbatimi efektiv dhe eficient të legjislacionit në fuqi;
- Çdo subjekt i inspektimit të AKEP ka marrë një leje, licencë apo autorizim nga AKEP për të kryer një aktivitet të caktuar dhe duhet të përmbushë kriteret e caktuara ligjore të përcaktuara në këto akte, si dhe ato detyrime të përcaktuara në ligj apo akte nënligjore, të cilat duhet të respektohen nga këto subjekte. Inspektimi krijon siguri se subjektet po funksionojnë në përputhje me këto kërkesa ligjore. Inspektimi mundëson ekspertizë, siguri, garanci se proceset e vendosura në këto subjekte janë të përshtatshme dhe operojnë në përputhje me standardet e përcaktuar ligjore;

Në këtë plan strategjik është përcaktuar diapazoni i fushave të inspektimit sipas akteve strategjike të AKEP dhe jo vetëm. Me fusha inspektimi nënkuptohen proceset për sa i përket procedurës, tematikat, lista e përgjithshme e verifikimit dhe dokumenteve parësor për t'u inspektuar, për sa më sipër parashtrihen në planifikimin tre vjeçar të DMKI sa vijon:

- Përcaktimi i procedurave të inspektimeve që kryen AKEP në zbatim të detyrimeve dhe ushtrimit të kompetencave ligjore, gjatë kontrollit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (*sipërmarrësve*) si dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve

elektronike (*subjekti*) sipas Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , akteve nënligjore, si dhe akteve administrative të nxjerra nga AKEP, në zbatim të këtij ligji;

- Përcaktimi i rregullave për konstatimin dhe shqyrtimin e kundra-vajtjeve administrative nëpërmjet inspektimit, monitorimit të spektrit të frekuencave dhe veprimit “*kryesisht*” të AKEP, përcaktimi i procedurave dhe i afateve të ankimit ndaj akteve të monitorimi-inspektimit të AKEP që vendosin masa administrative, si dhe i procedurave të ekzekutimit të sanksioneve administrative;

Planifikimi strategjik dhe ai vjetor i inspektimit duhet të bazohet kryesisht në vlerësimin periodik të riskut. Planifikimi mbi bazë risku përcakton se si mund të përdoren më së miri burimet e inspektimit, pasi është e qartë se koha dhe resurset që i kushtohen inspektimit çdo vit kufizohet nga burimet që ka në dispozicion struktura e inspektimit në AKEP. Kjo do të thotë që burimet më të shumta dhe më të kualifikuara të inspektimit duhet të alokohen në subjektet me risk më të lartë. Inspektim mbi bazë risku nënkupton gjithashtu inspektimet e kryera mbi një bazë të dhënash për sektorët, subjektet dhe objektet e inspektimit në fushën e tyre të veprimit, ku inspektorët mund të ushtrjnë funksione inspektimi, sipas së cilës subjektet me risk më të lartë inspektohen më shpesh se të tjerat.

- Risku në kuptimin e përdorur më sipër përfshin mendimin e rrezikut, por përmban dhe vlerësimin e mundësisë dhe të shkallës së ndikimit me efekte ndaj përdoruesve, aktorëve në treg dhe bashkëveprimit ndërmjet tyre. “Risk” gjithashtu është kombinimi i balancuar i rrezikut dhe i probabilitetit të shkakimit të dëmtimit. Risku në vlerësimin e kryer nga strukturat e AKEP në bashkëpunim me inspektimin duhet të përshkruajë gjithashtu jo vetë rrezikun dhe probabilitetin e dëmtimit por dhe pasojat e konstatuara në të njëjtën kohë;
- Vlerësimi i riskut është një procedurë sistematike dhe e vazhdueshme e DMKI në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e tjera në AKEP që ka për qëllim shqyrtimin, identifikimin, përcaktimin dhe kategorizimin e sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit në bazë të riskut që ato prodhojnë ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë. Vlerësimi i riskut është procesi gjatë të cilit shqyrtohet në mënyrë sistematike rreziku potencial që mund të shkaktojë subjekti i inspektimit. Prosesi përfshin, në veçanti, identifikimin e rreziqeve të mundshme që shoqërohen me mospërputhjen me standardet përkatëse ose me legjislacionin përkatës, si dhe vlerësimin e probabilitetit që këto rreziqe të çojnë në dëmtim. Vlerësimi i riskut kryhet periodikisht për çdo subjekt të Autorizuar nga AKEP.

Brenda misionit të Planit Strategjik të Inspektimit ka qenë dhe vazhdon të jetë dhe pavarësia e objektiviteti i inspektorit të autorizuar shtetëror pranë AKEP.

Kërcënimet e objektivitetit duhet të menaxhohen në nivele individuale angazhimi, funksionimi dhe organizative të inspektorit. Objektiviteti përshkruhet si një gjykim i paanshëm që i mundëson

inspektorëve të kryejnë kontrollet e subjekteve të inspektimit në mënyrë të tillë që të kenë besim për sa i përket produktit të punës të tyre dhe se nuk është bërë ndonjë kompromis për sa i përket cilësisë. Objektiviteti kërkon që inspektorët, për problemet e inspektimit, të mos varen në gjykimet e tyre nga të tjerët. Është shumë e rëndësishme që inspektorët të jenë të pavarur, por gjithashtu edhe të shihen nga të tjerët se janë të pavarur.

Inspektorët duhet të jenë të pavarur gjatë kryerjes së punës së tyre në mënyrë të lirë dhe objektive. Pavarësia u lejon inspektorëve që të japin gjykime të paanshme dhe të drejtpërdrejta që janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin e duhur të procesit të inspektimit. Kjo arrihet nëpërmjet statusit të inspektorëve profesionistë. Kryerja e inspektimit duhet të zhvillohet sipas kuadrit ligjor e rregullator dhe Standardeve të miratuara në fuqi dhe nuk i nënshtrohet asnjë ndikimi tjetër nga individë me autoritet, qofshin këta brenda apo jashtë institucionit. Inspektorët respektojnë rregullat e etikës dhe sjelljes në shërbimin civil. Pavarësia organizative e inspektimit është e rëndësishme dhe nënkupton që strukturat e inspektimit raportojnë direkt tek eprori i tyre i drejtpërdrejt. Strukturat e inspektimit gjithashtu nuk mund të angazhohen në detyra të tjera brenda AKEP të cilat nuk lidhen me funksionimin e sistemit të inspektimit.

3. Kuadri Ligjor.

- a) *Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.*
- b) *Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.*
- c) *Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;*
- d) *Rregullore Nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”.*
- e) *Rregullore Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën “.AL”, dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, org.al dhe .net.al”.*
- f) *Rregullore për Autorizimin Individual miratuar me VKD Nr. 510 datë 04.11.2008, shfuqizuar sipas nenit 13 të rregullores Nr. 30 datë 05.12.2013, miratuar me VKD Nr.2395, datë 05.12.2013.*
- g) *Rregullore e Autorizimit të Përgjithshëm Nr.47, datë 26.10.2017.*
- h) *Rregullore e Brendshme të AKEP miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 170 datë 24.04.2004, e ndryshuar.*
- i) *Rregullore Nr. 16 “Për Treguesit e cilësisë së shërbimit”.*

- j) *Rregullore Nr. 43 “Për mënyrën e zbatimit të “Portabilitetit të Numrit”.*
- k) *Rregullore Nr. 22 datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe fibrave optike nder urbanë të komunikimeve elektronike.*
- l) *rrjeteve kabllore urbane dhe fibrave optike nder urbanë të komunikimeve elektronike.*
- m) *Rregullore Nr. 27 datë 21/09/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.*
- n) *Rregullore Nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;*
- o) *Ligje të tjera që kanë lidhje me punën e DMKI;*
- p) *Akte të tjera normative si rregullore, urdhra, marrëveshje apo memorandume në fuqi të AKEP.*

4. Objektivat e Sektorit të Kontrollit dhe Inspektimit për Vitet 2020 - 2023

Mbikëqyrja, kontrolli dhe monitorimi i veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike si më poshtë vijon:

- i. Inspektime periodike e Sipërmarrësve të Komunikimeve Elektronike dhe Regjistrarëve të Domain-eve në përputhje me planin Strategjik dhe Vjetor sipas përcaktimeve të Rregullores Nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” dhe Rregullores Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën “.AL”, dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, org.al dhe .net.al”.
- ii. Ushtrimi i kontrollit në distancë i veprimtarisë së subjekteve ofrues të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike për çështjet e përshkruara në pikën 3.1.4 të Rregullores Nr.46, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” si dhe Urdhrit nr. 343, datë 7.06.2018 “Për procedurën e për inspektimit në distance, administrimin e informacionit të përfutur dhe planifikimit të tematikës së inspektimit dhe monitorimit” si prioritet i sektorit të kontrollit dhe inspektimit, e cila në bashkëpunon me sektorët e tjerë të AKEP kryen verifikime sistematike mbi detyrimet e ofruesve zbatimin e kuadrit rregullator. (*Rezultatet e inspektimit në distancë janë pjesë e informacionit për Tabelën e Vlerësimit të Riskut*).
- iii. Verifikimi me inspektime tematike i zbatimit të rregulloreve të AKEP-it, si Rregullores Nr. 16 “Për Treguesit e cilësisë së shërbimit”, të Rregullores Nr. 43 “Për mënyrën e zbatimit të “Probabilitetit të Numrit”, të Rregullores Nr. 22 datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe fibrave optike nder urbanë të

komunikimeve elektronike, të Rregullores Nr. 27 datë 21/09/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, Rregullores Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën “.AL”, dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, org.al dhe .net.al”, si dhe Rregullores Nr. 26 datë 16.08.2012 “Për Përmbytjen, formën dhe funksionimin e regjistrimit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

- iv. Parashikimi në Planet Vjetore dhe ato mujore apo dhe përfshirja në inspektime rastësore i subjekteve dhe përcaktimeve tematike miratuar në “Planin e Masave Organizative Për Verifikimin/Identifikimin e Subjekteve që Ofrojnë Shërbimin e Tranzitimit të Thirrjeve Telefonike Ndërkombëtare” të AKEP apo ato të përfuara kryesisht ose dhe nga shkëmbimet e informacionit institucional me DPT, DPP, QKB dhe agjenci të tjera shtetërore, por jo vetëm, në kuadër të luftës kundër informalitetit.
- v. Respektimin e kërkesave dhe parimeve të përcaktuara në pikën k, nenit 8 të Ligjit Nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Rregullores Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën “.AL”, dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al .edu.al, .com.al, org.al dhe .net.al”, e ndryshuar.
- vi. Verifikimin e regjistrimit të domain-eve nën “.al” në përputhje me Rregulloren Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al” si dhe verifikimin e regjistrimit të një domain-i nën zonën “.al” sipas procedurës përkatëse.
- vii. Bashkëpunim dhe inspektime të përbashkëta me ekspertët e DA me qëllim verifikimin e zbatueshmërisë në kryerjen e regjistrimit të domaineve nën.al, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- viii. Nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive ndërmjet ofruesve të shërbimeve komunikimeve elektronike, duke asistuar kur kërkohet nga DTMR dhe kryer inspektime të përbashkëta me ekspertët e saj për të garantuar dhe siguruar shërbim transparent, mos diskriminues dhe të ndershëm.
- ix. Bashkëpunimi i (DMKI) me Drejtoritë e tjera të AKEP-it për problemet e konstatuara si dhe realizimin e detyrave të përbashkëta, të cilat lidhen vetëm me funksionet inspektuese sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

5. Oëllimet Strategjike dhe Tematikat për Vitet 2020 – 2023

- I. *Zbatimi i Rregullores Nr.37, date 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për te garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.*

Verifikimi i detyrimit të sipërmarrësve që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, që të marrin masat e duhura gjatë projektimit, instalimit dhe funksionimit të rrjetit ose pajisjeve të përdorura, në mënyrë që të garantojnë sigurinë, integritetin dhe funksionimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, si dhe të paraqesin pranë AKEP, çdo ndërhyrje, cënim ose incident në sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të komunikimit elektronik publik që ka një impakt të konsiderueshëm në funksionimin e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të tyre.

- II. *Zbatimi i kushteve teknike të Rregullores Nr.22 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllorë urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike”.*

Verifikimi i përmbushjes rast pas rasti dhe në bashkëpunim me pushtetin lokal të kërkesave teknike që duhet të përmbushen në zhvillimin, planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Rrjeteve Kabllorë Urbane dhe Infrastrukturës së Rrjeteve me Fibra Optike Ndër-urbane të Komunikimeve Elektronike. Këto kushte janë një kornizë rregullatore për kushtet teknike që duhet të ofrojë ndërtimi i infrastrukturës së rrjeteve kabllorë apo i infrastrukturës së rrjeteve me fibër optike në fushën e komunikimeve elektronike.

Rrjetet kabllorë dhe rrjetet me fibër optike janë pjesë thelbësore e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, dhe i shërben zhvillimit, ndërtimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së tij në interes të Republikës së Shqipërisë.

- III. *Zbatimi i Rregullores Nr.43 Datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”.*

Verifikimi i garantimit dhe zbatimit të portabilitetit të numrit nga të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike dhe ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun, në përputhje me zgjidhjet teknike, mënyrën dhe afatet e përcaktuara në këtë rregullore.

- IV. *Zbatimi i Rregullores Nr.16 datë 16.04.2010 “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”, për mbulimin me shërbime broadband dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.*

Verifikimi i zbatimit të detyrimeve që sipërmarrësit kanë për treguesit e cilësisë së shërbimit për aksesin në rrjetin e qëndrueshëm (fiks) të komunikimeve publike dhe shërbimit telefonik të disponueshëm për publikun, aksesin në rrjetin e lëvizshëm të komunikimeve publike, dhe aksesin në Internet duke përfshirë edhe sigurimin e aksesit në rrjet, pavarësisht teknologjive të përdorura, të cilët maten nga sipërmarrësit që janë

përgjegjës për to.

- V. *Zbatimi i Rregullores Nr. 26 datë 16.08.2012 Për Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.*

Verifikimi i zbatimit nga të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike, i detyrimit për deklarimin dhe publikimin në sistemin Atlas të AKEP të rrjeteve të tyre sipas teknologjive të përdorura në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë rregullore.

- VI. *Zbatimi i Rregullores Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al” si dhe verifikimin e regjistrimit të një domain-i nën zonën “.al” sipas procedurës përkatëse.*

Verifikimin e emrave të domain-eve të regjistruar krahasuar me listën me emra të rezervuar të domaineve .al dhe nëndomaineve, sipas ANEKS 2/1 të Rregullores Nr. 2 date 21.02.2008.

Verifikim i numrit të domaineve në posedim nga një Individidi apo personi fizik/juridik sipas pikës b, Nenit 7 të Rregullores Nr. 2 date 21.02.2008, e cila përcakton një kufizim të numrit të domaineve që mund të ketë një subjekt/individ (5 për individë, 15 për subjekte por edhe më shumë në raste të arsyetuara).

Verifikimi për individë/subjekte që ofrojnë në faqet e tyre të web regjistrim domaine në zonën .al, të cilët nuk rezultojnë të jenë të Autorizuar nga AKEP për ofrimin e shërbimit të regjistrimit të domain name nën zonën .al.

- VII. *Zbatimi nga operatorët celularë të Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.21-24, datë 24.06.2019, për rregullimin e tarifave të roamingut ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor, sipas “Marrëveshje për reduktimin e cmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor”, të nënshkruar në Beograd më 4 Prill 2019 nga ministritë përgjegjëse për komunikimet elektronike të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, dhe Serbia.*

Verifikimi për përdorimin e paketave brenda vendit (me parapagim dhe paspagim) edhe në roaming në Ballkanin Perëndimor, sipas udhezimit të AKEP dhe modelit të aplikuar në BE. Njësitë (minuta/SMS/MB) që përdoren në roaming në BP, tarifohen sipas vlerave maksimale të përcaktuara, dhe këto njësi i zbriten njësisive përkatëse të përfshira në paketën që përdoret ka aktive brenda vendit. Pra përdorimi *Fol si n’shipi* edhe me paketën me parapagim apo paspagim si modeli i BE RLAH+. Apo tarifimi roaming sipas udhezimit të AKEP për përdoruesit me parapagim dhe me kontratë që nuk kanë një paketë aktive brenda vendit, ose kur kanë mbaruar njësitë e përfshira në paketë aplikohet nga të tre operatorët.

Duke mos përjashtuar edhe në vijimësi, verifikimin e zbatimit për:

- Bashkëveprimin e shërbimeve dhe interkoneksionin e rrjeteve;
- Sigurimin e disponueshmërisë dhe përdorimin e numrave nga plani i numeracionit për përdoruesit fundorë;
- Mbrojtjen e të dhënave vetjake dhe të privatësisë;
- Mbrojtjen e përdoruesve;
- Respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme, sipas rregullimeve përkatëse ligjore në fuqi;
- Marrjen e deklaramit nga ana e sipërmarrësve mbi lejimin e autoriteteve publike dhe të ngarkuara me ligj pa asnjë kufizim dhe pa asnjë pagesë për përdorimin e rrjetit dhe shërbimit internet, për të paralajmëruar publikun për kërcënimet e pashmangshme nga katastrofat e mëdha dhe për zbutjen e pasojave nga katastrofat e mëdha.
- Marrjen e deklaramit nga ana e sipërmarrësve mbi garantimin e zbatimit të përcaktimeve ligjore mbi lejimin vetëm të autoritetit të ngarkuara me ligj për përgjimin e informacionit në internet si dhe të bashkëpunimit me këto institucione sa herë ti kërkohet.
- Verifikimin e kushteve për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në rastet e gjendjes së emergjencës apo të gjendjes së luftës;
- Detyrimin për të ofruar akses sipas përcaktimeve ligjore;
- Detyrimin për të plotësuar standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve për ndërtimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronikë, si dhe të shërbimeve e faciliteteve shoqëruese.
- Verifikimin e regjistrimit të pajtimtarëve, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave për qëllime të ndjekjes penale sipas përcaktimeve ligjore

6. Inspektime të Bazuara në Vlerësimin e Rrezikut

Me qëllim të përmirësimit të caqeve të inspektimit të AKEP, ky Plan Strategjik i Inspektimit përcakton shfrytëzimin e vlerësimit të rrezikut nga inspektoratet për të caktuar metodikën e inspektimit. Sistemi i inspektimeve të bazuara në rrezik është alternativë e mirë e inspektimeve masive sic kemi patur gjate dy vitevete te fundit kalendarik 2018 dhe 2019. Siç është përmendur dhe më sipër, qasja aktuale është e bazuar në inspektimin e të gjitha hapësirave, procedurave dhe aktiviteteve, pavarësisht rrezikut të pasqyruar atij të mbartur si rrjedhojë e historisë së inspektimit.

Inspektimi i AKEP grumbullon të dhëna, si dhe monitoron dhe analizon situatën në fushën e mbikëqyrjes inspektuese që është në kuadër të fushëveprimit të tij. Mbikëqyrja inspektuese bazohet në vlerësimin e rrezikut dhe është proporcionale me rrezikun e vlerësuar në mënyrë që ai rrezik të menaxhohet në mënyrë efektive. Vlerësimi i rrezikut edhe sipas përcaktimeve normative të AKEP është pjesë e procesit të analizës së rrezikut, i cili përfshin menaxhimin e rrezikut. Sipas shkallës, rreziku mund të jetë i ulët, i mesëm, dhe i lartë. Rreziku vlerësohet nga struktura e inspektimit në AKEP në bashkëpunim dhe me drejtoritë e tjera të AKEP gjatë përgatitjes së planit vjetor të inspektimit si para dhe gjatë inspektimit. Gjatë zbatimit të planit vjetor të mbikëqyrjes inspektuese të ndryshimeve në rrethana në bazë të të cilave është vlerësuar rreziku dhe është hartuar një plan, inspektimi përshtat vlerësimin e rrezikut dhe planin e mbikëqyrjes inspektuese me rrethana të reja. Gjatë përgatitjes së planit strategjik të inspektimit, vlerësimi i rrezikut kryhet duke inspektuar monitorimin dhe analizën e situatës në fushën e mbikëqyrjes inspektuese që identifikon rreziqet sipas ligjit dhe rregulloreve tjera mbi të mirat, të drejtat dhe interesat e mbrojtur që mund të dalin nga biznesi ose nga sjellja e subjektit të mbikëqyrur, dhe sipas kriterëve të përshtatshme, vlerëson nivelin e pasojave të padëshiruara dhe gjasat e shfaqjes së tyre në mënyrë që të arrihet një vlerësim i shkallës së rrezikut. Përveç vlerësimit të rrezikut për subjektet e mbikëqyrura, në përputhje me kriteret e përcaktuara në mënyrë specifike në Metodikat e Inspektimit, rreziku në planifikimin tonë strategjik mund të vlerësohet për territore të caktuara dhe subjekte të tjera territoriale dhe të ngjashme (për shembull: njësitë territoriale, zonat dhe nën-zonat, ndërtesat etj.), objektet dhe grupet e objekteve, me mbikëqyrjen e inspektimeve dhe nevojën për ta kryer mbikëqyrjen inspektuese. Elementet e përbashkëta të vlerësimit të rrezikut në mbikëqyrjen inspektuese duhet të përcaktohen nga strategjia AKEP apo dhe marrëveshje, memorandume apo rekomandime të Kuvendit të RSH. Elementet specifike të vlerësimit të rrezikut dhe frekuenca e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese në bazë të vlerësimit të rrezikut, si dhe kriteret e veçanta, nuk duhet të përcaktohen nga metodikat përgjegjëse për fushën e duhur të mbikëqyrjes inspektuese por nga proceset e sipërmëndura inspektuese gjë që është e planifikuar dhe në ndryshimet ligjore të propozuara nga ne.

Ngritja e databazës inspektimit

Inspektim mbi bazë risku nënkupton inspektimet e kryera mbi një bazë të dhënash për sektorët, subjektet dhe objektet e inspektimit në fushën e tyre të veprimit, ku inspektorët mund të ushtrojnë funksione inspektimi, sipas së cilës subjektet me risk më të lartë inspektohen më shpesh se të tjerat për rrjedhojë;

- ✓ Inspektorët duhet të ngrenë një data bazë për sektorët, entitetet dhe palët subjekt i inspektimeve për fushën e veprimtarisë së tyre, ku ata mund të zhvillojnë aktivitetin e inspektimit.
- ✓ Standardizimi i informacionit për riskun duhet të jetë një proces vazhdues. Inspektorët duhet të procesojnë dhe ndajnë informacionin përshkrues të mbledhur mbi faktorët e riskut, i cili duhet të shprehet me anë të indikatorëve të riskut.

Përmbajtja e data bazës

1. Informacionin mbi riskun që sektorët e inspektimit prodhojnë për fushën e tyre të inspektimit;
2. Informacioni mbi riskun që prodhojnë entitetet, subjekt i inspektimeve të inspektoratit përkatës;
3. Informacioni për riskun që prodhojnë objektet e inspektimit në fushën e veprimtarisë të inspektoratit.

Këto pika të data bazës së inspektimit duhet të kenë në përbërje sa më poshtë :

- Inspektorët duhet të përcaktojnë faktorët e riskut të sektorëve, entiteteve dhe palëve të tjera subjekt i inspektimit, në bashkëpunim me komunitetin shkencor profesional i fushës së tyre të inspektimit dhe duke iu referuar standardit të praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Faktorët e riskut ndahen në faktorë risku si mundësi e jokonformitetit dhe faktorë risku në lidhje me efektet e jokonformitetit.
- Mundësia e jo-konformitetit lidhet me historikun e konformitetit dhe shpreh trendet e sektorëve dhe entiteteve, subjekt i inspektimeve në lidhje me interesin publik dhe intersat e ligjshme të personave fizik dhe juridikë.
- Efektet e jo konformitetit lidhen me dëmet dhe humbjet që mund të shkaktohen në rastet e jo konformitetit dhe shprehin ndikimin e sektorëve, entiteteve dhe palëve që janë subjekt i inspektimeve në interesin publik dhe në interesat e ligjshme të personave fizikë dhe juridik.
- Faktorët e riskut sipas pikës 2 duhet të përditësohen rregullisht, që të reflektojnë ndryshimet në kërkesat ligjore që të përmbushen/zbatohen nga sektorët, entitetet dhe palët subjekt i inspektimeve.
- Faktorët e riskut sipas pikës 3 duhet të përditësohen vazhdimisht, bazuar në fakte të reja për impaktet e sektorëve dhe entiteteve në interesin publik dhe në interesat e ligjshme të personave fizikë dhe juridikë, si dhe ndryshimi i kërkesave ligjore dhe ndryshime të tjera.

Struktura inspektuese e AKEP duhet të përcaktojë gjatë tre vjeçarit në vazhdim indikatorët e faktorëve të riskut të sektorëve, entiteteve dhe palëve të tjera që janë subjekt i inspektimeve, në bashkëpunim me komunitetin profesional/shkencor të fushës dhe me referencë si standard, standardet e praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Faktorët e riskut si pjesë e vlerësimit dhe analizave duhet të shprehin në terma sasiore madhësinë e riskut brenda të njëjtit faktor risku dhe midis faktorëve të riskut të ndryshëm. Indikatorët e faktorit të riskut duhet të përmbledhin në një shumë totale të gjithë faktorët e riskut. Madhësia e faktorëve të riskut duhet të përditësohet bazuar në prioritetet e inspektimit të përcaktuara në këtë Plan Strategjik, si dhe historia e inspektimeve të sektorëve, entiteteve dhe palëve objekt i inspektimit.

Struktura e inspektimit duhet të përmbledhë në total vlerën e indikatorëve të faktorëve të riskut në lidhje me mundësinë e jo-konformitetit dhe vlerën e indikatorëve të faktorëve të riskut në lidhje me efektet e jo-konformitetit të inspektimit të sektorëve, duke përcaktuar vlerën e përgjithshme të indikatorit të riskut për çdo sektor inspektimi. Kjo strukturë në zbatim të metodologjisë së riskut të përpunuar në këtë plan strategjik duhet gjithashtu të përmbledhë në total vlerën e indikatorëve të faktorëve të riskut në lidhje me efektet e jo-konformitetit të inspektimit të entiteteve subjekt i inspektimit, duke përcaktuar vlerën e përgjithshme të indikatorit të riskut për çdo entitet subjekt i inspektimit në funksion të vlerësimit të riskut që do përdoret për tre vjeçarit në vazhdim.

Vlersimi i riskut për Planin Strategjik.

Planifikimi i inspektimit përgatitet mbi bazë risku që nënkupton se inspektimi fokusohet në ato subjekte (sipërmarrës) veprimtaria e të cilëve përmban aspekte me mundësi të përlllogaritur e bazuar në probabilitet të përshkallëzuar të ushtrimit në mospërputhje të plotë ose në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe kuadrin rregullator.

- Vlerësimi i riskut kryhet gjatë gjithë procesit të inspektimit, veçanërisht në fazat e planifikimit në nivel Strategjik dhe vjetor, por dhe gjatë procesit të inspektimit.
- Vlerësimi i riskut është një procedurë sistematike dhe e vazhdueshme e DMKI në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e tjera në AKEP që ka për qëllim shqyrtimin, identifikimin, përcaktimin dhe kategorizimin e sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit në bazë të riskut që ato prodhojnë ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.
- Vlerësimi i riskut është procesi gjatë të cilit shqyrtohet në mënyrë sistematike rreziku potencial që mund të shkaktojë subjekti i inspektimit. Prosesi përfshin, në veçanti, identifikimin e rreziqeve të mundshme që shoqërohen me mospërputhjen me standardet përkatëse ose me legjislacionin përkatës, si dhe vlerësimin e probabilitetit që këto rreziqe të çojnë në dëmtim.
- Vlerësimi i riskut kryhet periodikisht për çdo subjekt të Autorizuar nga AKEP dhe ai logohet në database e inspektimit.

Analiza e riskut, e normuar në Metodikën e Inspektimit, mbi të cilën bazohet kryesisht Plani Strategjik i Inspektimit të AKEP, parimisht konsideron faktorët më relevantë me ndikim në treg

dhe në mundësinë e konsumimit nga ana e sipërmarrësit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së autorizuar, të veprave të parashikuara ligjërish si kundërvajtje administrative dhe/ose në mos përputhje me kushtet e përgjithshme dhe ato specifike sipas Autorizimit të Përgjithshëm dhe Autorizimit Individual për përdorimin e burimeve të fundme, me të cilët janë pajisur nga AKEP, si :

- a. *Pesha në treg e subjektit (sipërmarrësit) nga pikëpamja e rrjetit dhe shërbimeve publike që ofron si dhe peshës në treg referuar numrit të përdoruesve;*
- b. *Lloji, larmia dhe teknologjia e rrjeteve dhe shërbimeve që ofrojnë sipërmarrësit për publikun;*
- c. *Standardet teknike, infrastruktura dhe cilësia e rrjeteve dhe shërbimeve që ofrojnë sipërmarrësit;*
- d. *Numri i ankesave të pajtimtarëve dhe performanca e sipërmarrësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me pajtimtarët dhe midis sipërmarrësve;*
- e. *Performanca e plotësisimit të detyrimeve lidhur me sigurinë kombëtare, sigurinë e rrjeteve, mbrojtjen e të dhënave personale, regjistrimin e të dhënave identifikuese të pajtimtarëve, masave për gjendjet e jashtëzakonshme etj;*
- f. *Rezultatet historike të inspektimit;*
- g. *Indeksi i reagimit dhe plotësimi i rekomandimeve nga sipërmarrësit të rregullimit të shkeljeve të konstatuara dhe vendosura nga inspektorët dhe/ose AKEP, në aktet e inspektimit;*
- h. *Performanca e zbatimit të kushteve të veçanta të përcaktuara në aktet e AKEP për përdorimin e burimeve të fundme.*

Vlerësimi i riskut gjatë këtij Planifikimi Strategjik u krye duke analizuar në mënyrë të përgjithshëm veprimtarinë e sipërmarrësve të regjistruar në *data basë* e AKEP, referuar faktorëve ndikues të sipërcituar dhe më pas u reflektua edhe në matricën e riskut e përgatitur nga DMKI në bashkëpunim me strukturat e tjera në AKEP. Për arsye metodike të vlerësimit, subjektet e inspektimit kategorizohen sipas nivelit të mundshëm të rrezikut të riskut: të lartë, të mesëm dhe të ulët. Përcaktimet e Metodikës së Inspektimit për këtë kategorizim përcaktojnë si më poshtë:

- a) *Subjekte me rrisht të nivelit të lartë konsiderohen sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike mbi bazën e Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave të fituara si rezultat i një procedure konkurrimi publik si dhe sipërmarrësi që ka trashëguar rrjetin e operatorit ish incumbent të telefonisë fikse në vend;*
- b) *Subjekte me rrisht të nivelit të mesëm konsiderohen sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike: telefoni fikse, akses në internet, broadband, etj., me shtrije gjeografike në tërë territorin e vendit ose që kanë një numër përdoruesish aktivë mbi 800 pajtimtarë;*

- c) *Subjekte me rrisht të nivelit ulët konsiderohen sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike: fikse, akses në internet, broadband, etj., me shtrirje gjeografike të ngushtë ose që kanë një numër përdoruesish aktivë deri në 800 pajtimtarë.*

Në përfundim të vlerësimit të riskut, rezultatet e përfuara janë nxjerr në Raportin e Vlerësimit të Riskut (RVR), bashkëlidhur këtij Plani Strategjik të Inspektimit, duke i pasqyruar ato në Tabelën e vlerësimit të riskut për qëllim të Planifikimit Strategjik dhe atyre vjetor më pas sipas shembullit të Formatit Standard të parashikuar në MPI.

Përcaktimi i tematikave të inspektimit për këtë planifikim strategjik është kryer mbi bazën e riskut të vlerësuar sipas RVR.

Metodika e analizës së riskut gjatë planifikimit Strategjik paraqitur më lart është e njëjte me atë të analizës së riskut sipas metodikës së inspektimit duke e zbatuar në mënyrë më të thelluar dhe të detajuar, në kushtet e ekzistencës së rrethanave faktike të subjektit që po inspektohet. Mbi bazën e rezultateve të analizës faktike të riskut vendosen edhe penalitetet kur shkeljet e vërtetuara përbëjnë kundërvajtje administrative të parashikuar në nenin 136 dhe nenin 137 të Ligjit Nr.9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Masa administrative ose gjoba për shkeljet e vërtetuara vendosen duke vlerësuar kriteret:

- ① *Niveli i riskut të analizuar dhe pasojës si rrjedhojë e kundërvajtjes administrative të konsumuar;*
- ① *Statusit të sipërmarrësit në treg referuar shtrirjes territorial dhe afatit të fillimit të ushtrimit të veprimtarisë;*
- ① *Statusit të subjektit në raport me historikun e performancës së ofrimit të shërbimeve të autorizuar dhe rezultateve të inspektimeve të kryera më parë.*

7. Objekti i Përgjithshëm i Autorizimit të Inspektimit:

- ❖ Verifikimi i përdorimit të kapaciteteve të rrugëtimit dhe transmetimit, marrë nga sipërmarrësit e tjerë të autorizuar nga AKEP;
- ❖ Verifikimi i llojeve të shërbimeve që ofron aktualisht sipas kushteve të përcaktuara në Autorizim;
- ❖ Verifikimi i zbatimit të detyrimit të shtrirjes së rrjetit dhe ofrimit të shërbimeve bazë të komunikimeve elektronike sipas Autorizimit;

- ❖ Verifikim i implementimit të numrave të shkurtuar të emergjencës pa pagesë për përdoruesit e tij;
- ❖ Verifikim i përdorimit të frekuencave dhënë sipërmarrësit;
- ❖ Verifikimi i ankesave të ardhura për interferimin e frekuencave;
- ❖ Verifikimi i plotësimit të detyrimit për shërbim të pandërprerë 24 orë si dhe verifikim i burimeve të ushqimit rezervë.
- ❖ Verifikim i treguesve të cilësisë së shërbimit;
- ❖ Verifikimi i realizimit të shërbimeve ndër-urbane dhe ndërkombëtare;
- ❖ Publikimi i tarifave të instalimit dhe shërbimeve që ofron sipërmarrësi;
- ❖ Verifikimi detyrimeve financiare që ngarkon sipërmarrësi përdoruesit, në raport me ato të publikuarat;
- ❖ Verifikimi i furnizimit të përdoruesit me faturë mujore në formë të përmbledhur ose të detajuar;
- ❖ Verifikimi i kontratës së lidhur midis sipërmarrësit dhe përdoruesit në përputhje me dispozitat ligjore, e njehsuar me kontratën tip të miratuar më parë në AKEP;
- ❖ Verifikimi i ankesave të bëra nga përdoruesit, evindentimi, mënyra dhe afati kohor i zgjidhjes së tyre;
- ❖ Verifikimi i lidhjes së Marrëveshjes së Interkoneksionit me sipërmarrës të autorizuar të komunikimeve;
- ❖ Verifikimi konkret i aktivizimit të kod aksesit NDC dhe bllokut të numrave SN të dhënë nga AKEP, të veçantë për çdo komunë, sipas përcaktimit të bërë në Autorizim;
- ❖ Verifikim i shlyerjes së detyrimeve financiare vjetore brenda afatit;
- ❖ Verifikimi i mënyrës së realizimit të rrjetit të sipërmarrësit. Verifikimi i pajisjeve dhe aparaturave që sipërmarrësi përdor në rrjetin e saj, nëse ato janë të pajisura me certifikatë konformiteti të miratuar në AKEP;
- ❖ Verifikimi i frekuencave të dhëna për përdorim nga AKEP kur sipërmarrësi përdor pajisje radio në rrjetin e saj;

- ❖ Verifikimi i Zbatimit të Rregullores Nr. 26 datë 16.08.2012 Për Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrimit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;
- ❖ Verifikimi i zbatimit të Rregullores Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën “.AL”, dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, org.al dhe .net.al”.
- ❖ Verifikimi i Regjistruarve të Autorizuar nga AKEP për zbatimin e dispozitave të Rregullores sipër përmendur, lidhur me disponimin e faqes web me domain .al ose nëndomain .al., në gjuhën Shqipe, veçanërisht seksionin e faqes web të tij për domainet .al.
- ❖ Publikimin, përditësimin dhe raportimin e të dhënave të kërkuara, verifikimin e tyre sipas subjektit aplikues për domainin respektiv.
- ❖ Verifikimin për kërkimin automatik në sistemin e ccTLD .al nëpërmjet API nga Regjistruarët vetëm nga 1 (një) IP të para deklaruar.
- ❖ Verifikimin që Regjistruarët që domain-et në emër të tyre, janë vendosur në punë brenda afateve të përcaktuara.
- ❖ Verifikimi i detyrimit të Regjistruarët për të ofruar mundësinë e kërkimit për domain .al dhe nëndomaine, brenda 30 ditëve nga regjistrimi në AKEP.

8. Pritshmëritë dhe Angazhimi



DMKI ka përgatitur këtë plan strategjik të inspektimit që bën të mundur mbulimin e risqeve kryesore për fushat e inspektimit për një periudhë tre vjeçare 2020-2023. Që të sigurohen se inspektimi është efektiv, inspektorët duhet të kuptojnë plotësisht strukturën e subjektit që do të inspektohet, fushën ku operon dhe risqet kryesore me të cilat përballet. Për këtë arsye ky sektor përgatit periodikisht një plan strategjik ku parashtrihen veprimtaritë kryesore të planifikuara për një periudhë tre vjeçare dhe ku sigurohet që të gjitha subjektet/fushat me risk mbulohen gjatë kësaj periudhe.

Drejtimet kryesore që mbulon sipas këtij plani inspektimi janë

- ☎ kontrollin e objekteve të inspektimit dhe të produkteve;
- ☎ sistemi i menaxhimit të riskut;
- ☎ sisteme të tjera me risk që mund të lindin jashtë programimit vjetor si pasojë dhe e ndryshimeve në strategji të AKEP apo fushë ku operon;
- ☎ sisteme të procesit të sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Burimet e informacionit që kanë ndihmuar në procesin e planifikimit të këtij plani strategjik janë

të brendshme ose të jashtme në lidhje me subjektet e inspektimit. Burimet e brendshme të informacionit merren nga inspektimet dhe këshillimet e subjekteve që inspektohen. Inspektorët kanë kryer inspektime por dhe takime mbas inspektimit të here pas hershme me subjektet gjatë gjithë vitit, pasi:

-  bashkëpunojnë me subjektet për të parandaluar dhe këshilluar;
-  identifikojnë risqe të tjera për të cilat inspektorët mund të mos kenë dijeni.

Si pjesë e procesit të përgatitjes së planit strategjik të inspektimit, inspektimi i përmbahet disa dokumenteve kyçe, ku përfshihen raportet mujore, vjetore të inspektimit e të tjera materiale të jashtme të cilat ndihmojnë që të krijojë një panoramë mbi gjendjen e subjekteve të inspektimit, si dhe risqet që i duhet të përballojë për të kryer një planifikim sa më eficient dhe efektiv.

Me qëllim rritjen e nivelit të planifikimit strategjik DMKI ka nxitur bashkëpunimin jo vetëm me sipërmarrësit me të cilët është në bashkëveprim të vazhdueshëm institucional por dhe me drejtoritë e tjera në AKEP dhe institucionet e tjera qendrore dhe të pavarura, për të zbatuar një sistem ndjekje dhe bashkëpunimi duke synuar rritjen e nivelit të kontrollit për përgjegjshmërinë e zbatimit të rekomandimeve dhe marrjen e masave si instrument për të luftuar informalitetin, abuzimet dhe keqpërdorimin. Ky bashkëpunim, përcaktuar në vizionin e mësipërm strategjik për të ardhmen duhet zgjeruar e thelluar si në lëndë të parë (input), ashtu edhe në produkt (output) por dhe duhet të vijojë të stimulohet nga problematikat e evidentuara nga strukturat e tjera të AKEP, institucione të tjera shtetërore por dhe ato në media e shoqërinë civile, të përdorë qasjen shkencore e investigative, të dizajnojnë e formulojnë në të ardhme raporte sipas marrëveshjeve dhe memorandumeve të miratuara si ajo me tatimet apo ato të propozuara si ajo që presim me QKB por dhe si pas praktikave më të mira e ndërkohë dhe të lëvrojë në rrugë kapilare këto raporte tek të gjithë subjektet, për të krijuar një cikël apo zinxhir që ushqen dhe ushqehet nga kjo marrëdhënie.

Rritja e profilit të punës sonë në këtë aspekt është sfida e vërtetë që inspektimi ka në AKEP. Vetëm duke e bërë punën tonë inspektuese të kërkuar nga përdoruesit, vetë subjektet dhe Kuvendi, të mbështetur në probleme reale e të qenësishme, të besueshme përmes transparencës dhe profesionalizmit nga media, shoqëria dhe qytetari, inspektimi do të zërë vendin që i takon brenda institucionit dhe do të japë impaktin potencial që mbart edhe jashtë AKEP.

DMKI si struktura përgjegjëse e AKEP për inspektimin kontrollin dhe monitorimin, në vizionin e saj strategjik, ka qenë dhe do vijojë të jetë e angazhuar që në mënyrë të vazhdueshme të jetë strukturë bashkëveprues dhe gjithëpërfshirës për të maksimizuar kontributin që ofron, nëpërmjet zhvillimit të ekspertizës, për t'iu përgjigjur problemeve dhe sfidave që dalin dhe për të qenë e aftë të demonstrojë autoritetin e duhur për të gjeneruar impakt pozitiv për çështjet që inspektohen. DMKI synon të rrisë influencën dhe impaktin e inspektimeve të saj duke zgjeruar brënda dhe jashtë AKEP bazën e përdoruesve të produkteve të saj, siç janë gjetjet, opinionet dhe rekomandimet e inspektimeve, për t'i shërbyer qoftë përdoruesve direkt ashtu dhe indirekt, duke tentuar të përdorë kanale më efektive të komunikimit për të mbërritur deri tek përdoruesi më i fundit.

Gjithashtu, zbatimi i standardeve profesionale konsiderohet prej DMKI-së si një prej sfidave të vazhdueshme me të cilat përballen të gjithë strukturat inspektuese në çdo nivel. Implementimi i standardeve është një proces dinamik dhe një prej sfidave të zhvillimit institucional të vetë AKEP. Në përmbushje të këtij objektivi strategjik, DMKI është angazhuar në rishqyrtime dhe axhornime të metodologjive të inspektimit, proceseve dhe procedurave, për të siguruar përputhshmërinë e veprimtarisë inspektuese me standardet profesionale dhe vlerat.